

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Më 21.06.2022,

Prishtinë

Znj. Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme, Republika e Kosovës

REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANUAR DORËZUAR: DATE RECEIVED / SUBMITTED: 22.06.2022			
Nënie Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
05	47	1071	6


E nderuara znj. Spanca,

Me këtë letër përcjellëse iu dërgoj Planin e Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve për vitin 2022, nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), bazuar në Raportin e Auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2021 nga ana e Zyres Kombëtare të Auditimit (ZKA).

Plani i Zbatimit të Rekomandimeve të IAP-it për vitin 2022, është përgatitur sipas përgjegjësisë që rrjedhin për IAP në zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare të IAP për vitin 2021.

Ju faleminderit për mirëkuptim dhe bashkëpunim.

Me nderime,


Naim Qelaj
Avokat i Popullit.

Bashkangjitur:

Plani i zbatimit të rekomandimeve nga IAP.



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

Më 21.06.2022

Prishtinë

Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2022, sipas Raportit të Auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2021, nga **Institucioni i Avokatit të Popullit**

Mbi bazën e Raportit të Auditimit të Pasqyrave Financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) për vitin 2021, të nxjerrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), IAP e harton Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2022, sipas përgjegjësisë dhe afatit ligjor.

Me këtë Plan Veprimi të IAP të vitit 2022 merren obligimet dhe caktohen përgjegjësitë për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare të IAP për vitin 2021 nga ZAP, sipas këtij Plani për zbatim të rekomandimeve dhe afatit të caktuar.

Në formën dhe paraqitjen tabelare (sipas formularit unik të ZKA) e paraqesim Planin e Veprimit për vitin 2022, sipas përmbajtjes në vijim:

Nr.	Çështja A1, A2 e A3 dhe Rekomandimi: 1, 2 dhe 3	Plani i Veprimit nga IAP	Zyrtar-/ët përgjegjës	Periudha e zbatimit	Vërejtje/komente
1	Çështja A1: Pranimi i mallrave pa komision të pranimit. Rekomandimi 1: Avokati i Popullit, duhet të	1. IAP do të formoj komisionet përkatëse për pranimin e	1.Zyrtari Kryesor Administrativ(ZKA) i IAP.	1.Nga data hartimit të këtij plani te veprimit	Formimi i komisioneve do të bazohet sipas Opinionit ligjor të Zyrës Ligjore të Ministrisë e Financave, Punës dhe

	sigurojë që komisionet përkatëse për pranimin e mallrave/furnizimeve janë caktuar me kohë dhe se të gjitha pagesat bëhen bazuar në raportet e pranimit nga komisionet përkatëse sipas rregullave të përcaktuara.	mallrave/furnizimeve në depo dhe jashta depos, në pajtim me Nenin 8 të Rregullores MF - Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare.		nga IAP.	Transfereve për nenin 8 të Rregullores MF - Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare
2	Çështja A2 - Pagesa për dreka zyrtare pa dëshmi të duhura. Rekomandimi 2: Avokati i Popullit, duhet të identifikoj shkaktarët e mos respektimit të vendimit për shpenzimet e reprezentacionit dhe të siguroj kontrolle adekuate në mënyrë që mangësitë e tilla të mos ndodhin në të ardhmen.	2. IAP do të rishikoj vendimin për shpenzimet e reprezentacionit të zyrtarëve të IAP, në mënyrë që shpenzimet e reprezentacionit të realizohen me kontrolle adekuate.	1. Të gjithë zyrtarët të cilëve iu takon e drejta e shpenziimit të reprezentacionit, sipas vendimit.	1. Nga data hartimit të këtij plani të veprimit nga IAP.	2. Rishikimi i vendimit të IAP për shpenzimet e reprezentacionit të zyrtarëve të IAP do të bazohet në Udhëzimin Administrativ Nr.01/2008 për Caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit për zyrtarët e IQK - të Qeverisë të Kosovës
3	Çështja A3 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë. Rekomandimi 3: Avokati i Popullit duhet të hartoj një rregullore të brendshme për menaxhimin e pasurisë dhe t'i rishikoj kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurisë. Kontrollet në këtë fushë duhet të forcohen në mënyrë që pasuritë të ruhen nga humbja dhe keqpërdorimi i tyre si dhe të mirëmbahen regjistrat e pasurisë duke aplikuar zhvlerësimin tyre duke siguruar raportim të drejtë të gjendjes së tyre në PVF.	3. IAP do të hartoj rregulloren e brendshme për menaxhimin e pasurive jo financiare, përmes të cilës adresohet ruajtja e pasurisë jo financiare nga keqpërdorimi, për mirëmbajtjen e regjistrave adekuat të pasurisë si edhe për aplikuar zhvlerësimin e drejtë në PVF, si edhe procedura tjera për menaxhimin efektiv të pasurive jo financiare të IAP.	3. AP, ZKA, ZKF si edhe zyrtari i depos dhe pasurisë jo financiare.	3. Hartimi i rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022.	